



V E N D I M

Nr. 62 Date 04.06. 2008

PER

FILLIMIN E PROCEDURAVE PER LICENSIMIN E SHOQERISE “UNION EOLICA ALBANIA”

Në mbështetje të neneve 9 dhe 13 pika 8, të Ligjit 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, te ndryshuar, nenit 10 te “Rregullores per Procedurat e Licensimit”, te miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.21 datë 04.04.2007, dhe nenit 18 pika 3, te “Rregullave te Praktikës dhe Procedurave te ERE-s”, miratuar me Vendimin nr.44, date 24.07.2007, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 04.06.2008, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqeria “Union Eolica Albania” per tu licensuar ne aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit te centraleve elektrik me ere si dhe prodhimi i energjise elektrike, dhe konstatoi paraqitjen e plote te dokumentacionit te percaktuar ne Rregulloren e Procedurave te Licensimit

Vendosi:

1. Të filloj procedurat per licensimin e shoqerise “Union Eolica Albania” ne aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit te centraleve elektrik me ere si dhe prodhimi i energjise elektrike.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit te Tregut te njoftoje aplikuesin per vendimin e Bordit te Komisionereve te ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kryetari i ERE-s
Bujar Nepravishta